

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE

(DPPI)

Nr. Prot. 672, datë 23.09.2021

INSPEKTORIATI SHTETËROR I
MBIKQYRJES SË TREGUT

(ISHMT)

Nr. Prot. 2262, datë 23.09.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

DHE

INSPEKTORIATIT SHTETËROR TË MBIKQYRJES SË TREGUT

Lidhet kjo Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale**, me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, ish Shtëpia e Usharakëve, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Ledina Beqiraj.

dhe

2. **Inspektorati Shtetëror të Mbrojtjes së Tregut**, me adresë: Rruga Shyqyri Bërxolli, Nr 65, Tiranë 1001, përfaqësuar nga Kryeinspektori Z. Lavdrim Sahitaj.

(veçmas do të quhen si “Pala” dhe bashkarisht si “Palët”)

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në vijim “DPPI” është një agjenci autonome që siguron dhënie dhe mbrojtjen e objekteve të Pronësisë Industriale, në fushat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit, markave tregtare dhe të shërbimit, disenjovë industriale, treguesëve gjeografikë, topografive dhe qarqeve të integruara.

Drejtoria Përgjithshme e Pronësisë Industriale, është një agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë. Veprimtaria e saj përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin nr. 9947 dt. 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar dhe ligjin 8488 datë 13.05.1999 “Për Mbrojtjen e Topografive të qarqeve të integruara.

DPPI ka mision nxitjen e zhvillimit të Pronësisë Industriale duke përkrahur inovacionin, sipërmarrjen dhe duke nxitur promovimin e partneriteteve profesionale.

Gjithashtu, DPPI shërben si katalizator për zhvillimin e industrisë nëpërmjet mbrojtjes së pronësisë industriale.

DHE

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, në vijim “ISHMT”, është institucion qëndror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë me seli në Tiranë.

ISHMT-ja ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë

ISHMT, dhe përkatësisht Sektori i Pronësisë Industriale është përgjegjës për inspektimin, kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit të pronësisë industriale duke e mbështetur veprimtarinë tij mbi Ligjin Nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar dhe në Ligjin, Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

MEQENËSE:

Të dy këto institucione duke njohur rolin kyç që kanë në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale në territorin e Republikës së Shqipërisë, shprehin interesimin për lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi, me fokus shkëmbimin e informacionit dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e Pronësisë Industriale.

Marrë në konsideratë sa më lart, palët bien dakord për kushtet dhe afatet si më poshtë:

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi mes palëve për:

- a) Mbështetjen reciproke të funksioneve institucionale për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale.
- b) Rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve tregtare për të drejtat që ata gëzojnë në lidhje me objektet e pronësisë industriale të regjistruara.
- c) Informimi i publikut mbi veprimet që çenojnë të drejtat e Pronësisë Industriale.

Neni 2 Qëllimi

Me qëllim realizimin e objektit të kësaj marrëveshjeje, palët angazhohen në realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Të shkëmbejnë informacion në lidhje me objektet e pronësisë industriale të administruara në regjistrat e DPPI-së dhe rastet e cënimit të këtyre objekteve të trajtuara nga ISHMT, sa herë që ky informacion kërkohet nga palët për qëllime të përmbushjes së funksioneve institucionale përkatëse.
- b) Të mbajnë një komunikim efektiv ndërmjet tyre duke lehtësuar procedurat e shkëmbimit të informacionit zyrtar.
- c) Të përcaktojnë projekte të përbashkëta për mbrojtjen e pronësisë industriale.
- d) Të shkëmbejnë njohuritë që kanë të bëjnë me të rejtat mbi mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe që i përkasin fushave të veprimtarisë institucionale, të përfuara nga komunikimet me organizatat ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale.
- e) Të përgatisin dhe të shkëmbejnë materiale informuese dhe promovuese.
- f) Të zhvillojnë aktiviteteve të përbashkëta si seminare, konferenca, ekspozita, trajnime të ndryshme që kanë për qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e mbrojtjes së Pronësisë Industriale;
- g) Të mundësojnë vendosjen e materialeve promovuese në mjediset e ISHMT-së dhe DPPI-së në lidhje me informimin subjekteve për Pronësinë Industriale;
- h) Çështje të tjera me interes të përbashkët;

Neni 3 Detyrimet e Palëve

Në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë marrëveshje:

- a) Palët shkëmbejnë informacione sipas rastit në lidhje me objektet e pronësisë industriale, rastet e cënimit të të drejtave mbi objektet e Pronësisë Industriale, si dhe përditësimin mbi zhvillimet në fushën e Pronësisë Industriale.
- b) Palët shkëmbejnë informacionin zyrtar në rrugë elektronike dhe brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga pala që kërkon informacionin.
- c) Palët planifikojnë projekte dhe aktivitete të përbashkëta informuese mbi Pronësinë Industriale.
- d) Palët publikojnë dhe raportojnë rezultatet e bashkëpunimit, në përputhje me politikat dhe parashikimet ligjore në fuqi.
- e) DPPI merr përsipër të koordinojë projektet dhe aktivitetet e përbashkëta.
- f) DPPI merr përsipër të trajtojë ISHMT në lidhje me përdorimin e Regjistrit të objekteve të Pronësisë Industriale si dhe me ndryshimet e tij, i cili është i publikuar online në faqen zyrtare të DPPI dhe përmban vetëm informacion orientues
- g) DPPI merr përsipër të njoftojë ISHMT në lidhje me konferenca, seminare, trajnime me tematikë zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale të zhvilluara nga Organizatat Ndërkombëtare dhe zyrat homologe të vendeve të huaja me të cilat kanë komunikime, kur këto aktivitete u adresohen edhe institucioneve ligjzbatuese të Pronësisë Intelektuale.
- h) DPPI merr përsipër të vërë në dispozicion të ISHMT materialet informuese, specialistët dhe ekspertët që do të ofojnë seminare apo trajnime për personelin e ISHMT në fushën e Pronësisë Industriale;
- i) ISHMT merr përsipër të ofrojë mjedisin ku do të zhvillohen trajnimet e stafit të ISHMT dhe vendin ku do të vendosen standat dhe materialet promovuese;
- j) ISHMT merr përsipër të vërë në dispozicion materialet informuese, specialistët dhe ekspertët që do të marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta të parashikuara në këtë marrëveshje;
- k) ISHMT merr përsipër të vendosë në pikën e informacionit dhe në ambjentet e tij, fletë-palosje, të cilat do iu shpërndahen bizneseve gjatë aplikimeve që kryejnë, ku do të informohen mbi funksionet e DPPI;
- l) ISHMT merr përsipër të informojë për rastet e cenimit të të drejtave të Pronësisë Industriale, kur kjo i kërkohet nga DPPI për qëllime studimore;

Neni 4

Afati i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat të pacaktuar.
2. Përmbajtja e saj mund të ndryshohet nëpërmjet komunikimeve me shkrim mes palëve.
3. Në rast shfuqizimi të kësaj marrëveshjeje, palët duhet të njoftojnë njëra tjetrën paraprakisht me shkrim të paktën 60 ditë përpara zgjidhjes së saj, mundësisht duke parashtruar dhe arsyet përkatëse.

Neni 5
Monitorimi i zbatimit

Me qëllim në përmbushjen e objektit dhe qëllimit të kësaj marrëveshje DPPI merr përsipër të përgatisë një raport vlerësues çdo 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes. Raporti vlerësues do t'i paraqitet për miratim palës tjetër pasi ky raport të jetë diskutuar më parë në takimin e përbashkët mes përfaqësuesve të të dyja palëve që mbledhet me këtë qëllim.

Neni 6
Dispozita finale

Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e tij nuk është në tejkalim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre.

Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet sot më datë ___/___/2021, në 2 (dy) kopje origjinale me vlerë të njëjtë, një për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.


PALËT

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE**

Përfaqësuar nga:

Znj. LEDINA BEQIRAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



**INSPEKTORATI SHTETËROR I
MBIQYRJES SË TREGUT**

Përfaqësuar nga:

Z. LAVDRIM SAHITAJ

KRYEINSPEKTOR

